



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

01 Nr./ By: 27/25

Nr./ fq./ Br. sh: - 3 -

Data / Datum: 14.02.2025

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI  
OPŠTINA VUÇITRN

### PROCESVERBAL

**nga mbledhja e parë e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 20 janar 2025 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 10:15.**

Në mbledhje ishin të pranishëm: Melihate Basholli-Latifi (kryesuese), Mentor Hasani, Mensur Kasumi, Agron Perçuku, Fakete Dushi, Sylejman Mehollli dhe Fatmire Cecelia (anëtarë të KPF -së).

Mungoi: Nurie Halili.

Gjithashtu, në këtë mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive.

Mbledhjen e hapì dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit dhe e KPF-së, e cila konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë. Ajo tha se na janë bashkëngjitur edhe dy pika për t'i shtuar në rend të ditës:

- Kërkesë për mbështetje financiare;
- Propozim - vendim për ndarje të mjeteve financiare për furnizim me pako ushqimore për zyrtarë të komunës.

***Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këto dy pika që të shtohen në rend të ditës.***

***Komiteti për Politikë dhe Financa me pesë (5) vota "për" aprovoi këtë:***

### R E N D I T E

1. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 13.12.2024
2. Raport vjetor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore për vitin 2024
3. Propozim – vendim për përkrahje financiare
4. Kërkesë për mbështetje financiare
5. Propozim - vendim për ndarje të mjeteve financiare për furnizim me pako ushqimore për zyrtarë të komunës
6. Pyetje dhe përgjigje.

1. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 13.12.2024.

***Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 13.12.2024.***

2. Raport vjetor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore për vitin 2024.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

3. Propozim – vendim për përkrahje financiare.

**Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së** – jo vetëm për këtë pikë, por të gjitha pikat që kanë ardhur me vonesë nga kryetari i komunës, kanë të bëjnë me përkrahje financiare dhe subvencione. Këto çështje po na vijnë në kuvend në kohë të fushatës elektorale dhe nuk është praktikë e mirë kjo ndarje e subvencioneve në këtë mënyrë. Kjo është një lloj blerje votash nëpërmes subvencioneve. Por, përtej kësaj është shumë më e ndershme nga kryetari i komunës që t'i kryej borxhet e subvencioneve që nuk janë paguar në vitin 2024. Prandaj, propozimi im është që të kryhen pagesat e mbetura nga viti 2024, para se t'i ndajmë dikujt tjetër subvencione.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me tri (3) vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë “abstenim”, rekomandoi që të mos procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

4. Kërkesë për mbështetje financiare.

**Agron Perçuku, anëtar i KPF-së** – tha se nuk është kundër përkrahjes financiare, por, të vazhdohet përmes procedurave nëpërmes Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, sepse ne si anëtarë të KPF-së po vihemi në një situatë të palakmueshme. Drejtoria në fjalë e ka një komision, ku ka kërkesa mjaft për ndihmë financiare dhe nuk e dimë a po shqyrtohen a jo. Prandaj, këto kërkesa po përdoren në mënyrë selektive, sepse ata që po kanë njerëz, po i sjellin në kuvend, kurse të tjerët duhet të presin nga drejtoria që të shqyrtohen. Ka raste që kemi marrë vendim në kuvend dhe ende nuk u janë ndarë mjetet financiare. Prandaj, është mirë që të zbatohen vendimet e kuvendit ose le të vijnë për shfuqizim.

**Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së** – forma se si po i përzgjidhni rastet për t'i sjellë në kuvend për t'i subvencionuar për shuma financiare të mëdha nuk është korrekte as në aspektin mjekësor të vështirësisë së diagnozës, e as në aspektin human. Në këtë rast, po flasim për një fletë-lëshim dhe raportin mjekësor të vitit 2022, kurse ne jemi në vitin 2025. Prandaj, në këtë mënyrë po provohet t'i ndahen dikujt 3760.00€ me dokumentacione të vitit 2022, me disa intervenime (raporte të vitit 2024), të cilat nuk ndërlidhen me raportin e vitit 2022 dhe nuk kanë logjikë. Kam udhëhequr Drejtorinë e Shëndetësisë për tri vite dhe aty ka raste me qindra raste më të rënda se ky rast, e ku drejtoria i ndanë mjete financiare, apo nuk i ndanë fare. Kurse, ju po ndani mjete financiare për një frakturë – nga aksidenti i komunikacionit.

Praktika e ndarjes së subvencioneve nga kuvendi është praktikë e ndaluar, sepse duhet të ketë thirrje publike për shuma të mëdha financiare. Nuk jam që ta pengoj këtë rast, sepse nuk më lejon etika mjekësore, por këtu nuk kemi as logjikë mjekësore, humane, e as barazi.

**Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së** – deklaroi se nuk po trajtohen në mënyrë të barabartë as kërkesat e shëndetësisë. Ajo tha se vitin e kaluar ka qenë kjo kërkesë, por krejt çka ju paska bashkëngjijt kësaj kërkesë është një raport i kontrollës i vitit 2024. Madje, raporti nuk është i nënshkruar fare nga spitali. Nuk jam kundër askujt për t'i ndihmuar, por para disa muajve ka qenë një rast me kancer që është marrë vendim në kuvend dhe pala është

sorollatur nëpër komunë, sepse ende nuk ja keni bërë pagesën financiare. Po kërkohet përsëri sqarime lidhur me ndarjen e subvencioneve për fëmijët e porsalindur, që siç tha ajo ende nuk janë duke u bërë pagesat. Po ashtu, është marrë vendim edhe për Nazif Feratin, por ende nuk ja keni paguar mjetet financiare. Vendimet e kuvendit s'po i zbatoni.

*Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me pesë (5) vota "për" rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

5. Propozim - vendim për ndarje të mjeteve financiare për furnizim me pako ushqimore për zyrtarë të komunës.

**Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së** – kjo formë e përkrahjes financiare në kohë të fushatës zgjedhore nuk do koment. Mirëpo, populli nuk mund të blihet, sepse po jep mesazh të fuqishëm, pasi që ju po mendoni vetëm për zyrtarët e juaj, e jo për popullin. Po ashtu, nuk është korrekte nga ana e drejtorit të shëndetësisë, i cili vazhdimisht nuk merr pjesë as në mbledhje të KPF-së e as në kuvend.

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – kjo pako nuk lidhet me drejtorinë e shëndetësisë, andaj diskuto për pikën e rendit të ditës.

**Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së** – kryetari i komunës i ka mashtruar zyrtarët e komunës me shujtat ditore. Kryetari i komunës le t'ju tregojë fillimisht zyrtarëve se pse nuk ua jepi shujtat, e pastaj këto pako ushqimore janë shumë më të rëndësishme t'ua jep rasteve sociale, se sa zyrtarëve që marrin paga.

**Agron Perçuku, anëtar i KPF-së** – këto propozim-vendime për përkrahje financiare nuk është që po na vijnë vetëm nga kjo qeveri komunale, ka ndodhë edhe në qeveritë e kaluara komunale, por kjo po bëhet edhe nga qeveria në nivel qendror. Prandaj, jo rastësisht ndodhin në kohë fushate.

Ky është një propozim qesharak, që na kanë përfshirë edhe neve si kuvend komunal. Shpresojmë që mos të jetë edhe ky vendim, sikurse vendimi për shujtat. Prandaj, është mirë që të jepni sqarime në faqen e komunës për çdo veprim që ndërmerri.

*Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me tri (3) vota "për", një (1) "abstenim", rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

6. Pyetje dhe përgjigje.

Mbledhja përfundoi në orën **10:45**.

**Bujar Klinaku**



**Procesmbajtës**

**Melihate Basholli-Latifi**



**Kryesuese e KK-së dhe KPF-së**